



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 81/22

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 31.03.2022

VUÇITRAN - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, pika 1 e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28 qershor 2008); nenin 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nën-nënparagrafi 1.2.2, neni 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, nenin 11, nenin 16 dhe nenin 26 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor i datës 23/08/2013, Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore mbi Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nenin 41, paragrafi 1 dhe 2, pika (ç) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë Nr.28/11 dt.28/04/2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **31 mars 2022**, merr këtë:

VENDIM

PËR ZGJATJEN E AFATIT KOHOR PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

1. Me këtë vendim zgjatet afati kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë, i përcaktuar me vendim fillestar (nr. 255/18 – 5) të marrë më 27/9/2018 nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.
2. Afati shtesë për hartimin e Hartës Zonale të Komunës nga subjekti përgjegjës është 9 muaj (27/3/2022-27/12/2022), i cili i vazhdohet afatit të mëparshëm (27/9/2018 – 27/9/2020-27/3/2022).
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 82/22

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 31.03.2022

VUSHTRRI, VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31 mars 2022**, merr këtë:

VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR LIRIM NGA PAGESA E TAKSËS PËR
ÇERDHET PUBLIKE

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.29/22 i datës 31.1.2022 lidhur me lirimin nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që marrin shërbime nga çerdhet publike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br 83/22

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 31.03.2022

VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” në lidhje me nenin 17, paragrafi 1, shkronja “a” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **31 mars 2022**, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR PÛRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr.03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, me nr. të protokollit 01.nr.45/20 i datës 27.2.2020, në këtë përbërje:

- 1.1 Mentor Hasani, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Refik Maloku, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.4 Fatmir Feka, zyrtar ligjor në DEBPZHR dhe
- 1.5 Tefik Maloku, shef i Sektorit të bujqësisë.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të eidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave të rregullores dhe të përgatitë draftin “Propozim-ndryshimet e rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRËN	
01 Nr. / Br	84 / 22
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data / Datum	31. 03. 2022
VUSHTRRI - VUÇITRËN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 31 mars 2022 merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLORES PËR
TARIFA DHE NGARKESA KOMUNALE

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Nurie Halili, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.2 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.4 Bekim Selmani, shef i Sektorit të gjendjes civile;
- 1.5 Merita Rama, zyrtare për buxhet dhe financa.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë dhe hartojë Rregulloren për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale, duke e marrë për bazë rregulloren bazë dhe plotësim-ndryshimet e bëra nëpër vite, në mënyrë që të hartohet një tekst i spastruar i rregullores në fjalë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrriës.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

